

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "New Collection" Sh.p.k.

Sot, më datë 14/04/2022,

- **"Quadruple-A" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS L81322041P, me seli në: Rrugën "Muhamet Gjollësia", Godina Qendra Tregtare Ring, Hyrja 2, Apartamenti 14, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratorja e shoqërisë, Zj. Ira Hysaj.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "New Collection" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria")

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "New Collection" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", Pallati 11/1, Ap.12, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Ushtrimin e aktivitetit të faktoringut, ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve.
- Blerjen e kredive me probleme dhe menaxhimin e portofoleve të tyre. Mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe kredive me probleme për bankat e nivelit të dytë dhe të tretë. Rikuperimin e detyrimeve të prapambetura që kanë institucionet shtetërore, kompanitë private, etj.
- Kryerjen e cdo lloj veprimtarie që është në përputhje me legjislacionin shqiptar duke përfshirë dhënien e shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e shoqërisë.

- Këshillimin, përgatitjen e dokumentave ligjore si dhe përfaqësimin në gjykata dhe përpara institucioneve të tjera publike apo private.
- Monitorimin/ fillimin e procedurave përmbarimore me kërkesë të kreditorit (bankës, institucionit financiar), institucioneve apo kompanive.
- Shërbimin call-center.
- Shoqëria mund të themelojë, zotërojë, të marrë pjesë dhe kontrollojë shoqëri të tjera tregtare, apo të bashkepunojë, të lidhë marrëveshje jointventure a marreveshje të ngjashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë apo të ngjashëm me objektin e shoqërisë si dhe mund të lidh marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.
- Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, transaksione me pasuritë e luajshme dhe të paluajshme sipas parashikimeve ligjore.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 50,000,000 Lekë (pesëdhjetë milion) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **“Quadruple-A” Sh.p.k**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50,000,000 (pesëdhjetë milion) Lekë dhe 50,000,000 (pesëdhjetë milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Zj. Adriana Mehmeti**, shtetase shqiptare, lindur më 13/05/1986, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal I65513069L, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratoren Zj. Adriana Mehmeti** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

"Quadruple-A" Sh.p.k

Përfaqësuar nga

IRA HYSAJ

